



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



Procesverbal 5/2025

I mbajtur në mbledhjen e V-të të Komitetit për Komunitete, në Kryesimin e Osman Einit - Kryesues i Komitetit për komunitete, mbledhja u mbajt me datën 29.05.2025 në ora 10⁰⁰ në zyrën e takimeve të Kryetari i komunës.

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e Komitetit për komunitete;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të kaluar të Komitetit për Komunitete;
4. Shqyrtim dhe rekomandim nga Komiteti për Komunitete për mos marrjen e meditjeve të anëtarëve joasambleist në Ferizaj;
5. Diskutim se si mundemi me ndiku që qytetarët të marrin trajtim shëndetësor më të mirë pas orës 16⁰⁰ dhe
6. Të ndryshme.

Pika 1

Osman Emini - Kryesues i Komitetit për komunitete - E hapi takimin dhe konfirmoi pjesëmarrjen në mbledhje – Prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për komunitete.

Pika 2

1. U miratua rendi i ditës pa ndonjë vërejtje.

Pika 3

2. Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.

Pika 4

Osman Emini - Kryesues i Komitetit për komunitete – E hapi takimin e Komitetit për komunitete, dje ishim të pranishëm në Komunën e Shtimes për marrjen e një mostre se si e paguajnë Komitetin për komunitete.

Në Komunën e Shtimes pagesa bëhet nga Kabineti i kryetarit.

Osman Emini - Kryesues i Komitetit për komunitete – Të gjithë akterët brenda komunës i kemi taku.

Amir Rexhepi – Në mbledhjen e ardhshme të thirret Kryetari i Komunës z. Agim Aliu për të diskutuar çështjen e pagesave.

Flora Abdullahu – Mos ta presim takimin e radhës të Komitetit për komunitete, por të bëhet më herët.

Osman Emini - Kryesues i Komitetit për komunitete – Në takimin e radhës të ftohet z. Agim Aliu për të diskutuar çështjen e pagesave të anëtarëve të Komitetit për komunitete joasambleist.

Hajriz Hajrizi – Do të bëhet planifikimi i buxhetit 2025, aty do të ndahet buxheti për pagesa.

Osman Emini - Kryesues i Komitetit për komunitete – Po kalojmë te pika e V-të.

Pika 5

Osman Emini - Kryesues i Komitetit për komunitete – Diskutim se si mundemi me ndiku që qytetarët të marrin trajtim shëndetësor më të mirë pas orës 16⁰⁰, ka qytetar që po ankohen se qendrat e QKMF-së nuk po punojnë mbas orës 16.00, qytetarët presin 30-40 pacient me radhë dhe munden me marr infeksione.

Të bëhet mundësia që disa qendra të punojnë deri në ora 20.00, pjesëtarët e komunitetit duhet me paguar taxi edhe pse nuk i kanë kushtet dhe duhet të presin në radhë të gjatë.

REKOMANDIM - Komiteti për komunitete i drejtohet Drejtorisë së shëndetësisë që të merr disa hapa për mundësinë e aktivizimit të disa qendrave ambullantore të funksionalizohen edhe mbas orës 16.00.

Pika 6

Osman Emini - Kryesues i Komitetit për komunitete – Në të ndryshme nuk pati të interesuar për diskutim.

Osman Emini - Kryesues i Komitetit për komunitete – E mbylli mbledhjen e Komitetit për komunitete.

Procesmbajtësi


Xhemajl Jashari



Kryesuesi i Komitetit për komunitete


Osman Emini